

BASHKIA SARANDË
NJOFTIM PËR DHËNIEN ME QIRA

PËR DHËNIEN ME QIRA TË DHËNIEN ME QIRA TË SIPËRFAQES PREJ 60 HA, PJESË E PASURISË ME NR.8 DHE NR.15 ZONA KADASTRALE 2806 NË PRONËSI TË BASHKISË SARANDË PËR ZHVILLIM AKTIVITETI PRODHIM ENERGJIE NGA BURIME TË RINOVUESHME, NËPËRMJET PANELEVE FOTOVOLTAIKE

1. Autoriteti: BASHKIA SARANDË Adresa : Bashkia Sarandë , Rruga “Abedin Dino” 11
2. Dhënie me qira të sipërfaqes prej 60 ha nga fondi kullësor me konkurim publik Zona Kadastrale 2806, pjesë e pasurive 8 dhe 15 e cila bën pjesë në Ekonominë Kullësore “Heremec” të regjistruara në pronësi të Bashkisë Sarandë.
3. Qëllimi i dhënies me qira të fondit kullësor me konkurim publik të sipërfaqes 60 ha në pronësi të Bashkisë Sarandë, Zona Kadastrale 2806 Pjesë e pasurisë nr.8 dhe 15 e cila bën pjesë në Ekonominë Kullësore “Heremec”, në përdorim për zhvillim aktiviteti prodhim energjie nga burime të rinovueshme, nëpërmjet paneleve fotovoltaike
4. Konkurrimi do të zhvillohet me datë 08.09.2025 ora 11:00 në Sallën e Mbledhjeve , Bashkia Sarandë. Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: datë 08.09.2025 , ora 10.00.
5. Çmimi dysheme i qirasë është 176.000 lekë ha/vit x 60 ha = 10.560.000 lekë/vit, e përlogaritur sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike si dhe prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”
6. Afati i dhënies me qira të kësaj pasurie do të jetë 10 (dhjetë) vjet.
7. Kushtet e pjesëmarrjes në konkurim janë
 - a. Garanci financiare në vlerën 10 % e investimit të parashikuar në plan biznes ose garanci bankare
 - b. Të ketë të kontraktuar një specialist të fushës , ku në CV – në profesionale të tregohet përvoja në fushën e veprimtarisë
 - c. Vërtetim nga organet përkatëse shtetërore se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim,hetim në proces,detyrime tatimore ose detyrime të tjera ndaj të tretëve
 - d. Vërtetim për shlyerjen e taksave,tarifave dhe detyrimeve vendore
8. Ofertuesit janë të lutur të paraqesin vetëm një ofertë, në datën dhe orën e caktuar, dhe dokumentacionin si vijon :
 - Kërkesë së bashku me të dhënat për gjeneralitetet e tyre;
 - Certifikatën e regjistrimit dhe Ekstraktin e regjistrimit në QKB për objektin e veprimtarisë;
 - Projektin teknik të hartuar nga specialistë të licencuar ku janë trajtuar të gjitha elementet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar , i cili duhet të

përmbaj hartën topografike me kordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10.000, ku të jenë evidentuar elementët kryesorë, si kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, si dhe cdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit

- Planbiznesin dhe investimet që do të bëhen;
- Të dhëna për kapacitet teknike, stafin, makineritë dhe pajisjet që zotëron;
- Planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme;
- Raportin e vlerësimit të ndikimit mjedis nga ekspertë të çertifikuar
- Nivelin e punësimit në veprimtari;
- Dokumentacionin i cili provon aftësinë për përmbushjen e garancisë financiare në masën jo më pak se 10 % të vlerës së investimit të tilla si: pasqyrat financiare ose/dhe garanci bankare jo më pak se 10 % të vlerës së investimit, kontratë financimi ose letër angazhimi nga banka për sigurimin e vlerës së kërkuar, ose kombinimi të të gjithave parashikimeve në këtë pikë;
- Çmimin e qirasë së ofruar për ha/vit;
- Vërtetim nga organet përkatëse shtetërore se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim, hetim në proces, detyrime tatimore ose detyrime të tjera ndaj të tretëve
- Vërtetim për shlyerjen e taksave, tarifave dhe detyrimeve vendore
- Adresën e subjektit, telefon, email dhe faks.

Deklaratë se mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e dorëzuar në konkurrim. Në rast konstatimi të të dhënave të rreme, në cdo rast, Komisioni e skualifikon subjektin konkurrues.

9. Oferta paraqitet në një zarf të mbyllur me mbishkrimin “Ofertë për marrje në përdorim sipërfaqe kullimore”, i cili duhet të përmbajë një kopje origjinale ose të noterizuar të dokumentacionit të ofertës dhe ku të përcaktohen qartë identiteti dhe adresa e personit, fizik apo juridik të interesuar dhe të dorëzohen në zyrën e Protokollit të Bashkisë Sarandë, deri më datë 08.09.2025, ora 10.00.

10. Vlerësimi i ofertave do të bëhet sipas pikëve për kriteret e përcaktuara si më poshtë:

- | | |
|--|----|
| a) projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet, i cili përmban hartën topografike me koordi-natat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10000 ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si: kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, si dhe cdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit | 20 |
| pikë; | |
| b) planbiznesi dhe investimet që do të bëhen..... | |
| ...15 pikë; | |
| c) planin e rehabilitimit të sipërfaqes | |
|25 pikë; | |
| d) nivelin e punësimit në veprimtari | |
| ..5 pikë; | |
| e) masën e qirasë për ha/vit | |
|35 pikë | |